



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkiv, në Rektoratit e Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani”, shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune personel ndihmësakademik me kohë të plotë, specialist, në sektorin e burimeve njerëzore..

Personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, *Specialisti i Burimeve Njerëzore*: menaxhon dosje të personelit duke mbledhur të dhëna dhe përpunuar informacione sipas indikatorëve të menaxhimit të burimeve njerëzore; plotëson tabela me të dhënat e personelit apo dhe të tjera sipas kërkesave të ministrisë së linjës, duke bashkëpunuar me anëtarë të tjerë të drejtorisë dhe jo vetëm; menaxhon dokumentacion e personelit të UE-së; ndjek dhe zbaton procedurat dhe afatet e përcaktuara në lidhje me rekrutimin e personelit të UE-së. Raporton periodikisht në lidhje me punën e kryer.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme e të veçanta.

Kritere të përgjithshme:

- të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, ose ekuivalente me të në fushën e shkencave sociale. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe njehsuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- Të këtë përvojë të mëparshme pune.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj (preferohet anglisht) të vërtetuar me dokumentacion.
- Të ketë mbi 1(një) vit përvojë pune.
- Të ketë trajnime në fushën e burimeve njerëzore.
- Të jetë njohës i mirë i përdorimit programeve kompjuterike, word/excel.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**25.03.2024 – 04.04.2024**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Letër motivimi për pozicionin e punës *specialist* në sektorin e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Burimeve njerëzore protokoll arkiv në Rektoratit e Universitetit të Elbasanit “A. Xhuvani”;
- Jetëshkrimin e tij/saj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Librezë shëndetsore

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (25.03.2024 – 04.04.2024) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyra”,
Aplikim për pozicionin e punës: *specialist i burimeve njerëzore.*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Rektoratit. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (08.04.2024 – 18.04.2024). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen/njoftimi i fituesit.